



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË


KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



DITARI MUJOR

MAJ 2022



START UP - LEHTËSUES

11 Maj 2022, shënoi kalimin e pesë VKM, që plotësojnë kuadrin ligjor për mbështetjen e start up-ve dhe sipërmarrësve të rinj. Kjo VKM hapi rrugë financimit të dy kategorive të ekosistemit: **startup-eve** dhe **lehtësuesve të startup-eve**. Procesi i aplikimit nis me vetëdeklarimin online në **e-albania**, ku gjenerohet menjëherë **pasaporta e startup-it** nga ku nis marrjes së shërbimit “**One Stop Shop**” për 24 muaj, përvèç pjesës financiare do të marrin edhe këshillim.



AKTIVITETE NË PROMOVIMIN E THIRRJES

Në kuadër të aktivitetëve shkollore dhe akademike, u ndalem tek ajo çfarë na pret në të ardhmen, ku të rinxjtë zënë vendin e parë. Takimet me **stafet akademike**, **studentët e nxënësit** për t'i nxitur që të përfshihen në **thirrjen në ekosistemin e startup**. Takime në Universitetit Bujqësor të Tiranës, Universitetin e New Yorkut në Tiranë, Universitetin Polis, Gjimnazin Petro Nini Luarasi.

AUTOMOTIVE FAIR ALBANIA

Për herë të parë në Shqipëri, do të zhvillohet Edicioni I-rë i **Automotive Fair Albania**, iniciativë e Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. **Panairi** do të bashkojë së bashku të gjitha kompanitë, fabrikat, koncessionarët, nga rajoni, Evropa e bota. Risia, teknologjia dhe mbrojtja e ambientit janë pikëtakimi i këtij panairi.



VIZITË PUNË NË ITALI

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ishte në një **vizitë punë në Itali**, në kuadër të nxitjes së bizneseve që janë të interesura për **mundësi të reja zhvillimi në Shqipëri**. Në këto aktivitet kishte një prani të konsiderueshme të sipërmarrësve nga disa sektorë ekonomikë. Vizitat u ndaluan në Rajonin e Lombardisë, Dhoma e Tregtisë Bergamo, Asconfidi Lombardia.